UDHËZIM
Nr. 14, datë 29.9.2014

MBI ZBATIMIN E VENDIMIT NR. 277, DATË 18.6.1997, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBRIT", TË NDRYSHUAR

Mbështetur në pikën 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Shqipërisë, në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, të pikës 16 të vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 277, datë 18.6.1997 "Për përfitimet nga statusi i të verbrit", të ndryshuar

UDHËZOJ:

1. Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 277, datë 18.6.1997, bëhet 11.250 (njëmbëdhjetë mijë e dyqind e pesëdhjetë) lekë në muaj. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i të verbrit.

2.Efektet financiare, për zbatimin e këtij udhëzimi, fillojnë nga 1 shtatori i vitit 2014 dhe përballohen me fondet e akorduara për vitin 2014, për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

3.Udhëzimi nr. 7, datë 7.8.2013 i ministrit të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare dhe shtrin efektet nga 1.9.2014.

MINISTRI I MIRËQENIES SOCIALE
DHE RINISË
Erion Veliaj